



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 2
Prishtinë, më 24.10.2017, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Sergjan Mitroviç dhe Zafir Berisha.

Nga pjesëmarrësit e tjerë: Egnesa Vitia, praktikante; Gurjeta Zeka, LVV; Artan Murati, Jeta Krasniqi, KDI; Naim Jakaj, LVV-Kuvend dhe media.

Nga zyra e komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16 tetor 2017;
3. Diskutim lidhur me formimin e grupeve të miqësisë;
4. Diskutim lidhur me agjendën e takimeve të komisionit me ministrat përkatës;
5. Formimi i grupit punues për hartimin e planit për zhvillimin e diplomacisë parlamentare;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16 tetor 2017

Kryetarja konstatoi se komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 16 tetor 2017.

3. Diskutim lidhur me formimin e grupeve të miqësisë

Vjosa Osmani-Sadriu, bëri të ditur se grupet e miqësisë, në fillim të legjislaturës riformohen, ngase është e nevojshme që përbërja e re e Kuvendit të reflektohet në përbërjen e këtyre grupeve. Si Komision për Punë të Jashtme, tha se është detyrë e jona të shikojmë nëse ka nevojë të formohen grupe të reja të miqësisë, ndërsa ato të mëparshmet, 46 sosh, të shqyrtohen. Lidhur me formimin e grupeve të miqësisë, tha se ka disa propozime të reja, e po ashtu edhe propozime për plotësimin e grupeve të miqësisë nga legjislatura e kaluar.

Elmi Reçica, për formimin e grupeve të miqësisë, tha se kërkohet kohë, nëse komisioni merret nga fillimi për formimin e tyre dhe se nuk do të mund të konstituoheshin deri në fund të kësaj legjislature. Ai propozoi të formohet një grup i komisionit, i cili së bashku me Kryesinë e Kuvendit do ta përcaktonin plotësimin dhe ndryshimin e grupeve të miqësisë.

Zafir Berisha, pajtohet me diskutimin e z. Reçica, por theksoi se duhet të kërkohet një afat për realizimin e propozimit të komisionit, ngase formimi i këtyre grupeve, në legjislaturën e kaluar, ka marrë shumë kohë. Po ashtu, theksoi se formimi i grupeve të miqësisë, duhet të ketë një afat të caktuar, ndërsa numri shumë i madh i anëtarëve të një grupi të miqësisë, paraqet jo seriozitet. Theksoi se pajtohet që komisioni ta ketë parasysh formimin e grupeve të miqësisë me vendet strategjike që kanë ndikim.

Visar Ymeri, tha se mosfunksionimi i grupeve të miqësisë, në të kaluarën, ka qenë për shkak të trajtimit joserioz të Kuvendit, karshi grupeve të miqësisë. Nuk është kuptuar rëndësia e tyre dhe kjo rëndësi më shumë ka qenë individuale sesa strategjike. Po ashtu, theksoi se Kuvendi duhet të jetë komplementar karshi strategjisë së politikës së jashtme të Kosovës, dhe në kuadër të kësaj, të merren vendime se cilave grupe të miqësisë t'i japim rëndësi të veçantë. Më tej, theksoi se listën ekzistuese duhet ta rigrupojmë dhe duhet të shtojmë grupe të miqësisë, me ato vende që kanë rëndësi strategjike, ku Kosova nuk njihet, e lëre më të ketë ndonjë prezencë të theksuar.

Evgjeni Thaçi-Dragusha, tha se përkrah propozimin që grupet e miqësisë të jenë funksionale. Ato do të mund të strukturohen njëjtë si komisionet, nga aspekti i numrit dhe ai i përfaqësimit. Po ashtu, theksoi se vizitat e grupeve të miqësisë duhet ta kenë edhe qëllimin për të cilën janë formuar ato.

Time Kadrija, tha se pajtohet me diskutimet e parafolësve, duke shtuar se nuk duhet të lihet në vullnetin individual të deputetëve, përcaktimi i tyre për grupe të miqësisë, ngase secili do të kishte dëshirë me qenë në një grup të ndonjë vendi që e adhurojnë. Do të ishte mirë që shefat e grupeve parlamentare, ose me vendim të komisionit, të përcaktohet që një grup parlamentar të ketë një deputet në grup të miqësisë, ngase do të bëhej një ndarje më e rregullt.

Vjosa Osmani-Sadriu, bazuar në listën e legjislaturës së kaluar të grupeve të miqësisë, propozoi që:

- Grupi i Miqësisë Kosovë – Panama, të ndryshohet dhe të formohet si Grup i Miqësisë Kosovë – Panama, Amerikë Latine dhe Karaibe.
- Grupi i Miqësisë Kosovë – Zelandë e Re, të ndryshohet në Grup i Miqësisë Kosovë – Zelandë e Re dhe shtetet e tjera të Oqeanisë.
- Grupi i Miqësisë Kosovë – Britani e Madhe, të riformulohet Kosovë – Mbretëri e Bashkuar.
- Të formohet Grupi i ri i Miqësisë në mes të parlamentarëve të Kosovës dhe Australisë.
- Të formohet Grupi i ri i Miqësisë në mes të parlamentarëve të Kosovës dhe Çekisë, me arsyetimin se Republika Çeke është i vetmi shtet i BE-së, i cili na ka njohur dhe me të cilin nuk kemi grup të miqësisë.
- Të formohet Grupi i ri i Miqësisë në mes të parlamentarëve të Kosovës dhe Koresë së Jugut, për të cilin tha se është një shtet me ndikim në Azinë Lindore, si dhe një superfuqi

ekonomike, duke pasur parasysh peshën që ka ky shtet me SHBA-në, BE-në, Japoninë dhe Australinë.

- Të formohet Grupi i ri i Miqësisë në mes të parlamentarëve të Kosovës dhe Norvegjisë dhe Islandës, duke theksuar mes tjerash se Norvegjia e ka mbështetur Kosovën me projekte të ndryshme dhe ekspertiza.
- Grupi i Miqësisë i parlamentarëve Kosovë– Gana, të ndryshohet dhe të formohet si Grup i Miqësisë Kosovë – Gana, Senegal, ose Grupi i Miqësisë Kosovë – me shtetet afrikane.
- Të formohet Grupi i ri i Miqësisë në mes të parlamentarëve të Kosovës dhe Tajlandës, ngase Tajlanda është një shtet i rëndësishëm për Azinë Jug-Lindore.
- Të formohet Grupi i ri i Miqësisë në mes të parlamentarëve të Kosovës dhe Bosnjë e Hercegovinës. Përkundër mosnjohjes, kryetarja tha se duhet të kemi kontakte ndër-parlamentare me Bosnjë e Hercegovinën.
- Të formohet Grupi i ri i Miqësisë në mes të parlamentarëve të Kosovës dhe Izraelit, duke pasur parasysh se ai mban kontakte zyrtare me ne dhe pozitën gjeopolitike që ka ky shtet, edhe pse ende nuk e ka njohur Kosovën.
- Të formohet Grupi i ri i Miqësisë në mes të parlamentarëve të Kosovës dhe Jordanisë. Jordania është një vend aleat i Kosovës, një ndër shtetet e para që e kanë njohur pavarësinë e saj dhe me të cilin kemi shkëmbyer ambasador jo-rezident.

Doruntina Maloku-Kastrati, propozoi që grupet e miqësisë ekzistuese, me shtetet e Lindjes së Mesme, të përfshihen në një grup dhe të quhen Grupi i Miqësisë me shtetet e Lindjes së Mesme, në mënyrë që të reduktohet numri i grupeve të miqësisë dhe që të mos shpërndahen deputetët nëpër grupe të shumta.

Zafir Berisha, pasi e theksoi rolin e rëndësishëm të Panamasë, në rajon, propozoi që me secilin shtet të formohen grupe të miqësisë, për shkak të pozicioneve dhe përcaktimeve të tyre të brendshme politike, kushtetuese, si dhe politikën e tyre të jashtme.

Dukagjin Gorani, duke u ndërlidhur me propozimet e anëtarëve të komisionit për formimin e grupeve të miqësisë, theksoi se nëse e marrim për bazë grupimin e shteteve, do të mund të formoheshin grupe të miqësisë me Organizatën e Commonwealth-it, si dhe Organizatën për Shtetet e Amerikës. Ai theksoi se ekzistojnë grupe të shteteve, qoftë mbi baza ekonomike, qoftë mbi baza gjeografike.

Vjosa Osmani-Sadriu, theksoi se nuk mund të formohen grupe të miqësisë me Organizatën e Commonwealth-it, e po ashtu as me Organizatën për Shtetet e Amerikës, sepse kjo organizatë ka përfshirje shumë më të madhe sesa një rajon. Pos tjerash, ajo theksoi edhe mundësinë e avancimit të raporteve edhe me shtetin e Pakistanit, Afganistanit dhe Bangladeshit.

Elmi Reçica, theksoi se grupet e miqësisë duhet të formohen në mes të deputetëve të një parlamenti me deputetët e një parlamenti përkatës. Grupet e miqësisë mund të formohen edhe me ato vende që nuk kemi marrëdhënie diplomatike, gjë që do të mund të ndikojnë në përafrimin e kontakteve. Ai propozoi që Grupit të Miqësisë me Panamanë, t'i shtohet edhe me vendet e tjera, duke theksuar se është shumë i rëndësishëm Grupi i Miqësisë me Panamanë, ngase është selia e Organizatës Parlamentare për Amerikën Latine, përmes së cilës mund të ndikojnë te vendet e tjera.

Visar Ymeri, lidhur me formimin e grupeve të miqësisë, tha se duhet të rregullohet se cili është synimi dhe qëllimi që dëshirojnë të arrijnë me këto grupe të miqësisë. Pajtohet që përcaktimi i pjesëmarrjes së deputetëve në grupet e miqësisë, të bëhet nga grupet parlamentare, ndërsa vendimi për formimin e tyre, të merret në Kryesi. Ai tha se Kryesia duhet të ndajë buxhet për to, bazuar në një strategji të politikës së jashtme, për të cilën do të dakordohemi. Në propozim të kryetares së

komisionit, mori për obligim që të sjellë propozimin për formimin e grupeve të miqësisë me kontinentin e Afrikës.

Aida Dërguti, njoftoi se në legjislaturën e kaluar ka qenë anëtare në tri grupe të miqësisë, por me asnjërin nuk është zhvilluar ndonjë aktivitet. Ceku se do të ishte mirë që nga secili grup parlamentar të propozohen nga dy deputetë për një grup të miqësisë, në mënyrë që ato të mos jenë të mbingarkuara, siç kemi pasur rast me disa shtete. Njëkohësisht, theksoi se është e rëndësishme që kryesuesi i grupit të miqësisë t'i ketë të përcaktuara detyrat e tij. Duke u ndërlidhur me diplomacinë parlamentare, theksoi se është i rëndësishëm aktivizimi në organizata të rëndësishme ndërkombëtare. Bëri të ditur se anëtarësimi në Këshillin e Evropës ndodh me votat e Asamblesë Parlamentare dhe se aty mund të lobohet tek deputetët dhe se qasja është më e lehtë përmes Kuvendit. Diplomacia parlamentare është shumë e rëndësishme për sigurimin e njohjeve të reja dhe për anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Ajo propozoi që në përbërjen e grupeve të miqësisë, me vendet që nuk kemi njohje, të kemi strukturë të përgatitur dhe të jetë e përfshirë në masë të madhe gjinia femërore apo të vendosen kuota.

Vjosa Osmani-Sadriu, propozoi që formimi i Grupit të Miqësisë së parlamentarëve Kosovë – Panama të mbetet vetëm me Panamanë, deri tek formimi i Grupit të Miqësisë me Amerikën Latine.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

Përfundim

Të riformulohen dhe të formohen propozimet për formimin e grupeve të miqësisë, sipas propozimeve të anëtarëve të komisionit.

Formimi i grupeve të miqësisë, sipas propozimeve të dhëna, të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së komisionit.

4. Diskutim lidhur me agjendën e takimeve të komisionit me ministrat përkatës

Vjosa Osmani-Sadriu, lidhur me ftesën për raportim të Ministrisë të Jashtëm, bazuar në planin e punës së komisionit, tha se MPJ ka një fushëveprim të gjerë dhe nuk mund që të përfshihen të gjitha çështjet në një raportim të ministrit. Ajo propozoi që në javën e ardhshme të ftohet zëvendëskryeministri i parë, ministri i Punëve të Jashtme z. Behgjet Pacolli, që të raportojë në komision lidhur me strategjinë e Republikës së Kosovës, në raport me Marrëveshjen për demarkacion me Malin e Zi, si dhe për çështjen e tërheqjes së Kosovës nga aplikimi në anëtarësimin në INTERPOL dhe UNESCO. Po ashtu, theksoi se në muajin nëntor, mund të ftohet ministri i Jashtëm për të raportuar lidhur me çështjen e anëtarësimit në organizata të tjera ndërkombëtare, në veçanti, në Këshillin e Evropës, ndërsa në dhjetor do të mund të ftohej për temën lidhur me njohjet e Kosovës. Kryetarja bëri të ditur se ministri i Jashtëm ka shprehur interesimin që në vizitat e tij të përfshihet në delegacion edhe një deputet nga Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

Përfundim

Të ftohet ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Behgjet Pacolli, që të raportojë gjatë javës së ardhshme në komision, lidhur me strategjinë e Republikës së Kosovës, në raport me Marrëveshjen për demarkacion me Malin e Zi, si dhe për çështjen e tërheqjes së Kosovës nga aplikimi për anëtarësim në INTERPOL dhe UNESCO.

5. Formimi i grupit punues për hartimin e planit për zhvillimin e diplomacisë parlamentare

Vjosa Osmani-Sadriu, theksoi se është e nevojshme që komisioni të formojë një grup pune për hartimin e planit për zhvillimin e diplomacisë parlamentare. Në këtë grup duhet të përfshihen edhe zyrtarë të caktuar të MPJ-së, që të diskutohet edhe çështja e mbulimit të shpenzimeve lidhur me përfshirjen e një anëtari të komisionit tonë në delegacionet e MPJ-së. Ajo tha se është e nevojshme që të kemi një plan konkret për diplomacinë parlamentare, se çka konkretisht dëshirojmë të arrijmë në këtë drejtim. Në këtë plan do të duhej të përfshihet çështja e grupeve të miqësisë, funksionalizimi i tyre, raportet me MPJ-në, me MDIS, si dhe me kategoritë e tjera të shoqërisë.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

Përfundim

Formohet grupit i punues për hartimin e planit për zhvillimin e diplomacisë parlamentare, në këtë përbërje:

- 1. Doruntinë Maloku-Kastrati, kryesuese;*
- 2. Time Kadrijaj, anëtare;*
- 3. Danush Ademi, anëtar;*
- 4. Aida Dërguti, anëtare dhe*
- 5. Evgjëni Thaçi-Dragusha, anëtare.*

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu